



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:029563
Datë: 31.08.2023
Numri i dokumentit: 04636375

C.nr.76/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, i përbërë nga gjyqtari i vetëm Betim Behluli, në çështjen juridike të paditëses Kompania e Sigurimeve “SIGOS”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Arben Bellaqa nga fshati Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, për shkak të rimbursimit, vlera e kontestit 41,501.00 €, me datë 31.08.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Të paditurit Arben Bellaqa nga fshati Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, tani me adresë të panjohur, I CAKTOHET përfaqësuesi i përkohshëm avokati Gazmend Sharku nga Rahoveci.

Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht derisa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Ky aktvendim do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në një nga gazetatat e përditshme ditore, si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania e Sigurimeve “SIGOS”, me seli në Prishtinë, kësaj gjykate i ka ushtruar padinë kundër të paditurit Arben Bellaqa nga fshati Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, për shkak të rimbursimit.

Gjykata të paditurit Arben Bellaqa, i ka dërguar aktvendim për përgjigje ne padi të datës 18.11.2021, gjykata ka provë se për të njëjtin e kanë pranuar personi i tretë.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore për datën 28.08.2023, ku ftesës i është përgjigjur përfaqësuesi i autorizuar Rinor Ramadani, ndërsa për të paditurin askush nga fletëkthesa ekziston konstatimi se pala gjendet jashtë vendit. I autorizuari i paditëses i ka propozuar gjykatës që të caktoj përfaqësuesin e përkohshëm për të paditurin pasi që nuk i dihet adresa përkatësisht vendqëndrimi dhe vendbanimi i tij konform dispozitave të nenit 79 të LPK-së.



Duke marrë për bazë këtë gjendje faktike e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 79.3 a) të LPK-së, në anën tjetër duke marrë për bazë natyrën e lëndës urgjente, vendosi që të paditurit t'i caktoi përfaqësuesin e përkohshëm.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC

C.nr.76/2021, më, 31.08.2023

GJYKATËSI

Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimi. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.